



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 470 Prot.

Tiranë, më dt. 24.11.2017

VENDIM

Nr. 355, dt. 24.11.2017

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren e miratuar me vendim KKR nr. 75, date 03.04.2015 “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”, në mbledhjen e dt. 24.11.2017 Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, pasi shqyrtoi kërkesën për heqje licence për shoqërinë “BUILDING CONSTRUCTION” sh.p.k. dhe dhënie licence në fushën e restaurimit për Shoqërinë “ALTUSKONSTRUKSION” sh.p.k., me drejtues teknik Ark. Rest. Luçjano Bojaxhiu (R.P. 51),

VENDOSI:

1. Heqjen e licencës Shoqërisë “BUILDING CONSTRUCTION” sh.p.k. (R.SH. 38).
2. Të miratojë kërkesën e Shoqërisë “ALTUSKONSTRUKSION” sh.p.k. me drejtues ligjor Z. Luçjano Bojaxhiu për pajisje me licensë restaurimi për kategorinë:
“CP. Projektim për restaurim në monumentet e arkitekturës për shoqëri projektimi” dhe
“CZ. Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi” me drejtues teknik Ark. Rest. Luçjano Bojaxhiu (R.P. 51).
3. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, miratimin e kërkesës për pajisje me licensë restaurimi për Shoqërinë “ALTUSKONSTRUKSION, për kategoritë:
“CP. Projektim për restaurim në monumentet e arkitekturës për shoqëri projektimi” dhe
“CZ. Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi” me drejtues teknik Ark. Rest. Luçjano Bojaxhiu (R.P. 51).
4. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Mirela Kumbaro Furxhi



SEKRETAR I KKR I DELEGUAR

Arta Dollani